



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujevo

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

RAPORTI I PUNËS NGA DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2023

Në komunën e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural funksionin përmes dy sektoreve:

- Sektor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Sektor i Pylltarisë

Qëllimet kryesore të politikave bujqësore për vitin 2023 kanë qenë:

- *Kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale;*
- *Zbutja e papunsisë, varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët e zonave rurale.*


Objektivat e përgjithshme të DBPZHR për vitin 2023 kanë qenë:



- Edukimi i vazhdueshëm dhe përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural e poashtu edhe në sektorin e pylltarisë;
- Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;
- Mbështetja në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore si dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Podujevës.



Fokusi kryesor janë investimet në fushat si:

1. Pemëtaria -pemët e imëta (mjedra, dredhëza, manaferra, boronica dhe aronia);
2. Perimtaria;
3. Blegtoria;
4. Bletaria.

Projektet e realizuara gjatë vitit 2023, (realizuar përmes objektivave specifike në fushat përkatëse) janë:

N r.	Aktiviteti	Përshkrimi	Vlera e projektit €
1	<p>“Përkrahja e fermerëve me fidane të mjedrës”</p> 	<p>Është bërë përzgjedhja e 37 aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit të cilët janë mbështetur me 1000 euro vlerë monetare për çdo implementues të projektit në formën e pagesave direkte.</p> <p>Qëllimi kryesor -Ngritja e pemishteve moderne me mjedër si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta që janë strategjike për komunën tonë.</p>	

2	<p>“Përkrahja e fermerëve me feferona”</p> 	<p>Është bërë përzgjedhja e 13 aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit të cilët janë mbështetur me nga 500 euro vlerë monetare në formën e pagesave direkte.</p> <p>Qëllimi kryesor – Mbështetja e fermerëve dhe rritja e sipërfaqeve të mbjellura me perimkulturë.</p>	
3	<p>“Furnizimi dhe montimi i serrave për fermerë”</p> 	<p>Është bërë përzgjedhja e 45 fermerëve përfitues të projektit, te të cilët është bërë furnizimi dhe montimi i serrave.</p> <p>Fermerët përfitues këtë vitë janë përkrahur me serrë 300m² , duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës së tyre dhe duke krijuar kushte për gjenerim të të hyrave më të mëdha të tyre dhe vetëpunësim nga aktivitetet e tyre.</p> <p>Qëllimi kryesor- Ngritje të kapaciteteve të kultivimit të perimeve në ambiente të mbyllura (serra).</p>	254,722.50€
4	<p>“Furnizimi me mekanizëm</p>	<p>Përzgjedhja e 75 fermerëve</p>	134,550€

	<p>bujqësor”</p> 	<p>përfitues të cilët dhe përkrahja e tyre me mekanizëm bujqësor përkatësisht motokultivator 12HP</p> <p>Qëllimi kryesor- Rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës.</p>	
5	<p>“Furnizimi me mëshqerra”</p> 	<p>Përzgjedhja e 130 fermerëve përfitues të projektit dhe përkrahja e tyre me nga një mëshqerrë barrëse.</p> <p>Qëllimi kryesor- mbështetja e fermerëve në avancimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese si dhe rritjen e numrit gjedheve.</p>	351,000.00€

Projektet e realizuara në bashkëpunim me organizatat, donatorët gjatë vitit 2023

Nr.	Aktiviteti	Pëshkrimi	Vlera e projektit
1	“Furnizimi me mekanizëm bujqësor për familjet me kushte të rënda ekonomike”	Është bërë shpërndarja e mekanizmit bujqësor	68,090.00€




në mes të komunës së Podujevës dhe
organizatës “Qatar Charity”

**nga
marrëveshja e
bashkëpunimit
me nr.prot.02-
320/01-
0074859/22 të
datës 30.08.2022**

përkatësisht
motokultivatorëve me frezë
dhe kosë për 39 fermerët
përfitues të projektit dhe
motokultivatorëve me frezë,
kosë dhe rimorkio për 14
fermerët përfitues.

Numri total i familjeve
përfituese është gjithsej 53
në kuadër të memorandumit
të lartëcekur.

Qëllimi kryesorë- Rritja e
kapaciteteve prodhuese të
kulturave bujqësore përmes
përgatitjes më cilësore të
tokës për familjet me kushte
të rënda ekonomike.

2	<p>“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës” nga marrëveshja e bashkëpunimit në mes të komunës së Podujevës me organizatën “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës IADK”</p> 	<p>Përzgjedhja dhe motimi i serrave 176 m² për 10 fermerët përfitues, dhe shpërndarja e 4 paisjeve laktofriz për fermerët përfitues projektin 3 vjeçar.</p> <p>Në kuadër të kësaj marrëveshjeje është bërë përzgjedhja e 2 studentëve të drejtimit të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore për të kryer punën praktike me pagesë për periudhën tre mujore në kompani/ndërmarrje private që përshtaten me profesionin e tyre, me qëllim të punësimit dhe lehtësimit dhe qasjes në tregun e punës, ndërsa një grup prej 15 gra/vajza të kanë përcjellur programin e trajnimeve teorike dhe praktike në sektorin e përpunimit si dhe në kuadër të këtij aktiviteti do të ngritet një njësi përpunuese me një investim në vlerë prej 9000euro.</p>	65,260.00€
---	--	---	------------

		<p>Qëllimi kryesorë: Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe përkrahja direkte me grante në sektorin e bujqësisë, përpunimit të prodhimeve bujqësore, digjitalizimit të bujqësisë dhe ndryshimeve klimatike si dhe përkrahja e studentëve me punë praktike.</p> <p>Fokusi kryesor: Përkrahja e grave/vajzave në zonat rurale në ngritjen e aftësive profesionale në sektorin e përpunimit, të cilat më pastaj do të kenë mundësi të gjenerojnë të hyra nga puna e tyre.</p>	
3	<p>“Përkrahja e fermerëve me mëshqerra” nga marrëveshja e bashkëpunimit me OZHR Mëshqerra”</p>	<p>Në kuadër të projektit për përkrahjen e fermerëve me mëshqerra nga marrëveshja e bashkëpunimit me OZHR Mëshqerra” është bërë shpërndarja e farës së misrit përfituesit e grupit të dytë të mëshqerrave.</p>	

4	“Mbjellja e drunjëve dekorativ”	Në bashkëpunim me FINCA Kosova është realizuar mbjellja e 70 drunjëve dekorativ nëpër lokacione të ndryshme të përzgjedhura.	
5	“Mbështetja e fermerëve me Mekanizëm Bujqësor” nga marrëveshja e bashkëpunimit me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim -TIKA”	Është bërë përzgjedhja e 50 fermerëve përfitues të projektit të cilët janë përkrahur me Freza dhe modeli farmers 1.65	39,500.00€

Projektet e realizuara në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2023:

DBPZHR bazuar në kriteret e MBPZHR-së është angazhuar në mbështetjen e fermerëve të komunës së Podujevës në përgatitjen e dokumentacionit të duhur për aplikimin e tyre në këto skema si dhe në përcjelljen e tyre në MBPZHR për shqyrtim dhe miratim. Ky aktivitet është zbatuar dhe është i ndarë sipas thirrjeve të MBPZHR-se për sektorët përkatës.

- **THIRRJE PËR APLIKIM- Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, vëçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2022-** Në kuadër të kësaj thirrje nga MBPZHR nga data 12.01.2023 deri me datë 10.02.2023 ora 16:00 janë pranuar gjithsej 78 aplikacione të fermerëve të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe miratim.
- **THIRRJE PËR APLIKIM- Për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore për vitin 2023-** Në kuadër të kësaj thirrje nga MBPZHR nga data 28.02.2023 deri me datë 14.04.2023 në ora 16:00 janë pranuar gjithsej 2210 aplikacione të fermerëve të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe miratim.

Gjatë kësaj periudhe i gjithë stafi i DBPZHR ka punuar me kapacitet të plotë, duke

përfshirë edhe punën jashtë orarit të rregulltë të punës e poashtu edhe punën gjatë vikendeve.

AKTIVITETE TË TJERA TË REALIZUARA

- Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF);
- Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave, me ç'rast gjatë kësaj periudhe janë lëshuar gjithsej 35 vendime për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Kërkesa për subvencione;
- Kërkesa për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore;
- Kërkesa të ndryshme.

SEKTORI I PYLLTARISË

DBPZHR-Sektori i pylltarisë bashkëpunon ngushtë me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës dhe zbaton me përpikëri politikat e sektorit të cilat në fokus kryesor e kanë stabilizimin afatgjatë të gjendjes.

Objektivi kryesorë i DBPZHR në kuadër të sektorit të pylltarisë është që të zvogëlohen sa më shumë:

- Prerjet ilegale;
- Sëmundjet e ndryshme dhe
- Të evidohen dhe pengohen zjarret pyjore, kullosat ilegale, deponitë e mbeturinave, nxjerrja e gurëve, zhavorit, dheut etj.



Aktivitetet e realizuara nga sektori i pylltarisë gjatë vitit 2023

- Me qëllim të kontrollimit të qarkullimit të masës drusore të prerë në mënyrë ilegale, zbulimin dhe kontrollimin e vendshkarkimeve të drurit teknik dhe drurit për lëndë djegëse në afërsi të rrugës ose në vend të prerjes janë realizuar plane operative përkatësisht kontrollera të rregullta nga ana e shërbimit të mbrojtjes dhe shërbimit teknik të pylltarisë në bashkëpunim edhe me asistencën e zyrtarëve policorë, ku si rezultat është konfiskuar masë drusore në sasi prej 134.06 m³.
- Nga shërbimi i mbrojtjes, përkatësisht rojet e pyllit janë pranuar gjithsej 195 fletëparaqitjeve kundërvajtëse si dhe 23 fletëparaqitje penale të cilat janë përcjellur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë dhe në Prokurori.
- Me qëllim të konstatimit dhe regjistrimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dëmeve pyjore nëpër rajone të ndryshme ekonomiko-pyjore deri më tani janë përfunduar 7 revizione pyjore në Rajonin Ekonomiko-pyjor Murgullë, Turuqicë, Zllapushë, Popovë, Tërnavicë, Sekiraqë dhe Dumnicë.
- Është intensifikuar dhënia e shërbimeve të qytetarëve që bëjnë shfrytëzimin e asortimenteve drusore në mënyrë legale — leja për prerje në pyjet private, me ç'rast deri më tani 121 pronarë të pyjeve private janë paisur me leje për prerje të pyllit në prona private ndërsa të hyrat nga shërbimet në pyje private janë **15,698.74** euro .
- ❖ Realizimi i kontratës për shitjen e masës drunore 140 m³ dru zjarri nga depoja e përkohshme e pylltarisë në fshatin Peran.
- ❖ Përfundimi i punimeve për shitjen e masës drunore në ngastrat 063-II Shakovicë, 63-02 NJM Murgullë-Bellasicë, 103 Orllan dhe 167-02 Bradash, sipas udhëzimeve të APK-së.
- ❖ Realizimi i shitjes me pakicë të masës drunore në ngastrën 152-0 Bradash.

Podujevë

Nr. 12-320/01-001/22/24

Datë:

